



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 34
10.12.2015

NR. VENDIMI 27
11.12.2015

V E N D I M

“Për Sekuestrim Pasurie”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej

GJYQTAR: Sandër SIMONI

Asistuar nga sekretare séance **Evloinda ADILI**, sot në datë 11.12.2015, ora 10.00 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale Nr.34 Regj. me:

KËRKUES:

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda - Tiranë, përfaqësuar nga Prokurore Enkeleda Millonai.

KUNDËR:

O. H. (A.), e bija e F. dhe e R., datelindja xxxx, lindur ne xxxx dhe banues ne xxxx, me lagja “xxxx”, e martuar, me arsim te xxxx, e padenuar, me shtetesi shqiptare.

OBJEKTI:

Sekuestrim pasurie.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit, nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Në përfundim të gjykimit gjykata, pasi e gjeti veten kompetente për të gjykuar dhe vendosur, mbi kërkesën e paraqitur, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", pasi dëgjoji diskutimin përfundimtar të prokurorit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

V Ë R E N

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë xxxx, regjistroi procedimin pasuror Nr.xx, Viti xxxx në ngarkim të shtetases O. H. (A.) , si person i dyshuar për kryerje të veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë , "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga neni 287/1/a/b i Kodit Penal. Procedimi pasuror ishte rrjedhojë e procedimit penal Nr. xxxx Viti xxxx, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx

Nga materiali hetimor, që Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx i dërgoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, rezultoi sa më poshtë:

E pandehura O. H. (A.), në cilësinë e xxxx së xxxx, nëpërmjet falsifikimit të dokumentave dhe veprimeve në kundërshtim me ligjin për përmbushjen e rregullt të detyrës, **në vitin xxxx ka rregjistruar në rregjistrat e pasurive të paluajtshme të Z.Rr.P.P xxxx në emër të personave të tjerë pasurinë e paluajtshme të llojit truall me sipërfaqe prej xxxx m², ndodhur në lagjen "xxxx", xxxx, pasuri e cila përbën produkt të veprës penale.**

Në vijim të veprimeve të kundraligjshme, pasi janë bërë edhe disa transaksione të tjera lidhur me pasurinë e paluajtshme produkt të veprës penale, **e pandehura O. H., në vitin xxxx duke përdorur dokumenta të falsifikuara në bashkëpunim me të pandehurin K. T., ka transferuar pronësinë e pasurisë së paluajtshme produkt të veprës penale te persona të tjerë, kundrejt përfitimit të vlerave monetare nga transferimi i kësaj pasurie, duke fshehur origjinën e paligjshme të kësaj pasurie, duke fshehur dhe mbuluar burimin dhe zhvendosjen e pronësisë së kësaj pasurie, si dhe duke ditur që pasuria e paluajtshme në fjalë përbën produkt të veprës penale.**

Më konkretisht;

I.Në datën xxxx nga Z.Rr.P.P xxxx është lëshuar një vërtetim hipotekor, nga përmbajtja e të cilit A. I. B. ka të rregjistruar në rregjistrin hipotekor në numrin xxxx, viti xxxx, pasurinë me nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, me

sipërfaqe xxxx m² truall, ndodhur në lagjen "xxxx", xxxx.

Nga këqyrja e kryer rregjistrin të notave të transkriptimit të Z.Rr.P.P xxxx, volumi XX, vitet xxxx, rezulton se ndodhet e shënuar një notë transkriptimi në favor të A. I. B., për pasurinë truall me sipërfaqe xxxx m². Kostatohet gjithashtu se **numri i kësaj note transkriptimi është e shënuar me fraksion (xxxx)**, rrethanë kjo që nuk konstatohet në notat e tjera të transkriptimit, si dhe me sy të lirë vihet re se shkrimi i kësaj note transkriptimi është i ndryshëm nga ato të notave të transkriptimit paraardhëse dhe pasardhëse.

Në Z.Rr.P.P xxxx ekziston një **indeks alfabetik**, në të cilin janë të shënuar emrat e personave sipas notave të transkriptimit si dhe sipas viteve. Në këtë indeks alfabetik ndodhen emrat e të gjithë personave në favor të të cilëve është rregjistruar notë transkriptimi në vitin xxxx dhe xxxx, sipas rendit të tyre alfabetik, por **nuk rezulton që të jetë i shënuar emri A. I. B.**

Në datën xxxx në zyrën e **Noterit B. A.**, në xxxx, është lidhur kontrata e shitjes me nr.xxxx Rep dhe nr.xxx Kol. Në këtë kontratë si **shitës rezulton emri A. I. B.**, e datëlindjes xxxx banuese në lagjen "xxxx", xxxx, e përfaqësuar nga një person i besuar **A. B.**, i biri i B., i datëlindjes xxxx, i përshkruar në kontratë si djali i saj. Në cilësinë e blerësit në kontratë rezultojnë shtetasit **P. L. dhe G. Z.** Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate shtetasit P. L. dhe G. Z. kanë blerë një sipërfaqe trualli prej xxxx m², e ndodhur në zonën kadastrale nr.xxxx, e cila gjendet e rregjistruar në rregjistrin e pasurive me nr.xxxx, pasuri e cila është shitur për shumën prej xxxx lekë.

Nga hetimet e kryera ka rezultuar se **personat me emrin A. I. B.**, e datëlindjes xxxx, banuese në xxxx, si dhe **A. B.**, i biri i B., i datëlindjes xxxx, banues në xxxx, **nuk ekzistojnë**, konfirmuar ky fakt me shkresën me nr.xxxx prot dt.xxxx të Ministrisë së Brëndshme, me shkresën me nr.xxxx prot dt.xxxx të Zyrës së Gjëndjes Civile të Bashkisë xxxx, me shkresën me nr.xxxx prot dt.xxxx të Zyrës së Gjëndjes Civile pranë Prefektit të Qarkut xxxx, si dhe me proces verbalin për këqyrjes e rregjistrin të gjëndjes civile, datë xxxx.

Në vlerësim të rrethanave të mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin që personat e mësipërm nuk ekzistojnë, duke marrë në konsideratë faktin që në indeksin alfabetik të Z.Rrr.P.P xxxx lidhur me notat e transkriptimit nuk rezulton që të jetë i shënuar emri A. I. B., të shkruarit me numër me fraksion të numrit të notës së transkriptimit, arrihet në përfundimin se **pasuria e paluajtshme nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx vol xx, e llojit truall, me sipërfaqe xxxx m², e ndodhur në lagjen "xxxx", xxxx, është rregjistruar mbi bazën e dokumentave të falsifikuara**

dhe se kjo pasuri e paluajtshme përbën produkt të veprës penale.

II. Nga hetimet e mëtejshme lidhur me këtë procedim penal ka rezultuar se vërtetimi hipotekor i Z.Rr.P.P xxxx i datës xxxx, në emër të A. I. B., është përgatitur dhe përpiluar nga shtetasja O. H. (A.), e cila në këtë kohë ka ushtruar funksionin e xxxx pranë Z.Rr.P.P xxxx dhe ka punuar në lidhje me xxxx në emër të A. B..

Po kështu, shtetasja O. H. (A.) ka qënë punonjësja përkatëse pranë Z.Rr.P.P xxxx, e cila ka përgatitur dhe ka përpiluar xxxx me nr.xxxx, datë xxxx, për të njëjtën pasuri të paluajtshme në emër të shtetasve P. L. dhe G. Z..

Lëshimi i vërtetimit hipotekor i datës xxxx në emër të A. I. B. për pasurinë me sipërfaqe xxxx m² është lëshuar në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 "*Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme*", që ka qënë në zbatim në atë periudhë, pasi përvec faktit që nota e transkriptimit përmban rrethana të rreme, nuk ka qënë një dokument i mjaftueshëm për të lëshuar vërtetimin hipotekor në emër të A. B. si dhe për të rregjistruar më pas pasurinë e paluajtshme në rregjistrin hipotekor në emër të P. I. dhe G. Z.. Vërtetimi hipotekor mundet që të lëshohej vetëm do të ekzistonte titulli i pronësisë në emër të A. B., si ato që janë parashikuar në nenin 24 të ligjit të mësipërm dhe nota e transkriptimit nuk përfshihet në parashikimet e kësaj dispozite.

Për këtë shkak në datën xxxx për pasurinë e paluajtshme në fjalë nga Z.Rr.P.P xxxx është nxjerrë urdhër kufizimi, duke vendosur në seksionin përkatës të kartelës së kësaj pasurie të paluajtshme se ndalohen veprimet pasi për këtë pronë nuk ka ndonjë vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, xxxx.

Duke vlerësuar në tërësi burimet e provës të administruara gjatë hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, rezulton se lidhur me rrethanat e mësipërme nga e pandehura O. H. janë konsumuar veprat penale "*falsifikimi i dokumentave*" dhe "*shpërdorimi i detyrës*", të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të K.Penal, por duke qënë se fakti penal ka ndodhur në vitin 2002 ndjekja penale lidhur me këtë episod është parashkruar, që përpara se të rregjistrohej ky procedim penal.

III. Në datën xxxx në zyrën e **Noterit B. A.**, në xxxx, është lidhur kontrata e shitjes me nr.xxxx Rep dhe nr.xxxx Kol, sipas të cilës pasurinë e paluajtshme prej xxxx m², e ndodhur në zonën kadastrale nr.xxxx, shtetasit P. L. dhe G. Z. ia kanë shitur shtetasve A. L. dhe F. C..

Në vijim, sipërfaqja e truallit të mësipërme është rregjistruar në rregjistër me

pasurinë me nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, vol xxx, ndodhur në lagjen "xxxx",
xxxx.

Shtetasi A. L. është bashkëshorti i shtetases V. L., ku kjo e fundit është motra e të
pandehurës O. H. (A.).

Është kryer ekspertimi i shkrimit "A. L.", të ndodhur në kontratën e datës xxxx dhe
nga akti i ekspertimit grafik me nr.xxxx, datë xxxx të Drejtorisë së Policisë Shkencore
xxxx, ka rezultuar se shkrimi i emrit "A. L." nuk është i njëjtë me shkrimin e të
njëjtit person të ndodhur në praktikën e pajisjes me pasaportë për jashtë shtetit të
shtetasit A.L.. Pra, shkrimi i emrit "A. L." në kontratën e shitjes të datës xxxx është
me përmbajtje të falsifikuar.

Në datën xxxx në zyrën e Noterit A. D. është lidhur kontrata me nr.xxx Rep dhe
nr.xxx Kol, me shitës A. L. dhe F. C., të përfaqësuar nga i pandehuri K. T., dhe në
cilësinë e blerësit ka qënë shtetasi A. R..

Në praktikën e kësaj kontrate shitje ndodhet edhe dokumenti prokurë e
përgjithshme me nr.xxxx Rep dhe nr.xxxx Kol, datë xxxx, e përpiluar në zyrën e
Noterit Sh. H., në xxxx, sipas të cilës A. L. dhe F. C. kanë emëruar si përfaqësues të
tyre të pandehurin K. T.. Nga hetimet e kryera nuk rezulton që shtetasi F. C. të
ketë nënshkruar në prokurën e mësipërme.

Në datën xxxx midis shtetasve K. T. dhe A. R. është lidhur edhe kontrata e
porosisë me nr.xxx Rep dhe nr.xxx Kol, ku sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, në
këmbim të shitjes së pasurisë së paluajtshme, pala porositëse, të përfaqësuar nga
shtetasi K. T., do të përfitonte nga pala e porositur edhe një garsoniere si dhe një
apartament me sipërfaqe xxx m². Edhe në lidhjen e kësaj kontrate është përdorur
prokura e përgjithshme nr. xxx Rep dhe nr.xxx Kol, datë xxxx, e përpiluar në zyrën e
Noterit Sh. H..

Prokura e mësipërme ndodhet e rregjistruar në rregjistrin e veprimeve noteriale të
Noterit të mësipërm, por në arkivën e këtij Noteri nuk ndodhej prokura origjinale.
Është administruar gjatë hetimeve një kopje e prokurës se përgjithshme, në të cilën
ndodhet nënshkrimi në emër të shtetasve A. L. dhe F. C., si dhe i bashkëshorteve të
tyre respektive V. L. dhe E. C., por duke qënë se ky dokument ishte në fotokopje nuk
mund ti nënshtruhej ekspertimit grafik.

Megjithatë, në praktikën e dokumentave të ndodhur në Z.Rr.P.P xxxx ndodhej në
original prokura e përgjithshme e datës xxxx, e nënshkruar në emër të shtetasve V.
L. dhe E. C., por në rekuizitën e emrave A. L. dhe

F. C., prokura nuk është e nënshkruar. Nga akti i ekspertimit nr.xxxx, datë xxxx të Drejtorisë së Policisë Shkencore xxxx, rezulton se **prokura e mësipërme nuk është nënshkruar nga shtetasja E. C. dhe se nënshkrimi i ndodhur në këtë prokurë në emër të shtetasës V. L., duhet që të jetë shkruar nga e pandehura O. H..**

Sipas prokurorisë, provohet tej cdo dyshimi se prokura e përgjithshme e datës xxxx është me përmbajtje të falsifikuar, pasi nuk është nënshkruar nga shtetaset V. L. dhe E. C., si dhe duke vlerësuar konkluzionin e aktit të ekspertimit grafik në lidhje edhe me burimet e tjera të provës, si dhe në lidhje me mekanizmin e kryerjes së veprës penale, provohet plotësisht se në emër të shtetasës V. L. ka nënshkruar motra e saj, e pandehura O. H..

Janë kryer një sërë veprimesh hetimore me qëllim verifikimin e rrethanave të lidhjes së kontratës së shitjes midis të pandehurit K. T. dhe shtetasit A. R., të datës xxxx.

Në kontratën e shitjes së mësipërme është përshkruar se cmimi i shitjes së pasurisë së paluajtshme është xxxx lekë, shumë e cila përshkruhet se është likujduar jashtë zyrës noteriale. Nga pyetja dhe më pas ballafaqimi i shtetasit A. R. dhe të pandehurit K. T. rezulton se pavarësisht faktit që kontrata e shitjes është nënshkruar nga i pandehuri K. T., **cmimi i blerjes i është paguar të pandehurës O. H., e cila ditën e lidhjes së kësaj kontrate ka marrë këstin e parë prej xxxx lekë, ndërsa disa ditë më pas ka marrë përsëri këstin e dytë me të njëjtën shumë.**

Fakti që e pandehura O. H. ka qënë në të vërtetë personi që ka shitur pasurinë e paluajtshme tek shtetasi A. R., e cila ka bashkëpunuar për lidhjen e kontratës së shitjes me të pandehurin K. T. është provuar edhe nga rezultati i veprimeve të tjera hetimore, të kryera nga organi procedues ditën e ballafaqimit të personave të mësipërm, konkretisht nga përgjimi i bisedave ambientale të kryera midis shtetasve A. R., F. C. dhe të pandehurit K. T..

Nga hetimet e mëtejshme ka rezultuar se **KRRT-ja e Bashkisë xxxx me vendimin me nr.xxxx, datë xxxx ka miratuar shesh dhe leje ndërtimit**, për truallin e rregjistruar në emër të A. R., me qëllim ndërtimin e një godine banimi dhe shërbime x kate, por kjo lejë ndërtimi është revokuar me vendimin me nr.xxxx, datë xxxx Bashkisë xxxx.

Në vlerësim të të gjitha rrethanave të mësipërme, duke marrë në konsideratë veprimet e kundraligjshme të kryera nga e pandehura O. H.:

- në vitin xxxx lidhur me rregjistrimin e pasurisë së paluajtshme në emër të A. B., që është një person i cili nuk ekziston,
- faktin se transferimi i pronës në emër të shtetasit A. L., i cili është bashkëshorti i motrës së të pandehurës O. H., është kryer duke falsifikuar shkrimin e shtetasit A. L.,
- faktin se nënshkrimi i shtetases V. L. në prokurën e përgjithshme të datës xxxx është shkruar nga e pandehura O. H.,
- faktin se është kryer shitja dhe transferimi i pasurisë në datën xxxx me anë të të pandehurit K. T., i cili është i njohur i bashkëshortit të saj A. H., por që cmimin e shitjes së pasurisë e ka marrë vetë shtetasja O. H.,

rezulton se e pandehura O. H., në datën xxxx nëpërmjet përdorimit të dokumentave të falsifikuara, përdorim të cilin e ka kryer në bashkëpunim me të pandehurin K. T., të prokurës së përgjithshme datë xxxx të falsifikuar, si dhe certifikatës së pronësisë datë xxxx së bashku me kartelën e pasurisë që janë të falsifikuara nga ana e përmbajtjes së tyre, **ka transferuar pasurinë prej xxxx m², që është produkt i veprës penale, me qëllim fshehjen e origjinës së paligjshme të kësaj pasurie, si dhe ka fshehur dhe mbuluar burimin dhe zhvendosjen e pronësisë së kësaj pasurie, duke ditur që përbën produkt të veprës penale.**

Ndërsa, i pandehuri K. T. në marrëveshje me të pandehurën O. H. ka përdorur prokurën e përgjithshme nr.xxx Rep dhe nr.xxx Kol, datë xxxx me të dhëna të falsifikuara, para zyrës së Noteres A. D. në lidhje e kontratës të datës xxxx, në lidhjen e kontratës së porosisë së datës xxxx, si dhe në caktimin e përfaqësuesit të posacëm në datën xxxx, me anë të prokurës së posacme nr.xxxx Rep dhe nr.xxxx Kol.

Për sa më sipër, i pandehuri K. T. është vlerësuar nga prokuroria se ka konsumuar të gjithë elementët e veprës penale "*falsifikimi i dokumentave*", më shumë se një herë, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal, ndërsa e pandehura O. H. (A.) ka konsumuar tërësisht të gjithë elementët e figurës së veprave penale "*falsifikimi i dokumentave*", më shumë se një herë, në bashkëpunim, si dhe "*pastrimi i produkteve të veprës penale*", të parashikuar nga nenet 287/1, gërmat (a) dhe (b) të Kodit Penal, sipas përmbajtjes së kësaj dispozite përpara ndryshime të kryera me ligjin nr.23/2012.

Çështja penale në ngarkim të kësaj shtetaseje, siç rezulton është dërguar per gjykim, sic pasqyrohet ne kerkesen per gjykimin e ceshtjes nr. xxx te vitit xxxx, pasi eshte akuzuar me date xxxx per kryerjen e veprave penale te "*Falsifikimit te dokumentave*" me shume se nje here, ne bashkepunim, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal, si dhe "*Pastrimi i produkteve te vepres penale*" parashikuar nga neni 287/1

germa a dhe b te K.Penal., sipas permbajtjes se kesaj dispozite perpara ndryshimeve te kryera me ligjin nr. 23/2012.

Përsa më sipër, vërehet se në referim të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", shtetësja O. H. (A.) është subjekt i hetimit pasuror sipas n. 3 pika 1, gërma "d". Ndaj saj, ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në aktet e administruara, për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale.

Me kërkesë të Prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx me vendimin me nr.xxx, datë xxxx, Gjykata, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit pasuror "sekuestro preventive", për pasurinë e paluajtshme nr.xxxx, zona kadastrale nr. xxxx, vol xxx, faqa xxxx, e llojit truall, ndodhur në lagjen "xxxx", xxxx, me sipërfaqe xxxx m².

Sa më sipër kjo pasuri plotëson kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe korrupsionit, Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë", pasi:

Së pari: ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova që shtetasja O. H., mund të jetë përfshirë në veprimtari kriminale siç është ajo e falsifikimit te dokumentave dhe në vijim veprimtarinë kriminale të pastrimit të produkteve të veprës penale;

Së dyti, siç vërehet, pasuria ne fjale, nga te gjitha te dhenat rezulton se nuk eshte fituar nga ndonjë burim i ligjshëm, perkundrazi eshte fituar si pasoje e veprimeve te falsifikimit te cilat automatikisht e bejne nul veprimin juridik te shitje - blerjes;

Së treti, ekziston rreziku i humbjes apo tjetërsimit te kesaj pasurie, e cila sic rezulton kalon dore me dore, per shkak se O. eshte munduar te zhvendose pronesine e saj dhe eshte pikerisht kjo pasuri produkt i vepres penale;

Pra pavaresisht se kjo pasuri aktualisht ndodhet ne doren e nje personi te trete, e konkretisht shtetasit A. R., ne origjine kjo pasuri nuk i ka perkitur asnje prej shitesve qe ne origjinen qe daton qe ne vitin xxxx dhe gjithashtu rezulton se per shitjen e kesaj pasurie perfaqesuesi me prokure, ka qene K. T. si perfaqesues i shitesve A. L. dhe F. C., kur ne te vertete keta te fundit nuk kane nenshkruar ndonjehere prokuren.

Sa me siper eshte e domosdoshme te procedohet menjehere me sekuestrimin e pasurise, konkretisht pasurise se paluajtshme me nr. xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, vol xx, ndodhur në lagjen "xxxx", xxxx, me sipërfaqe xxxx m².

Për të mbështetur këtë kërkesë Prokuroria ka sjellë si prova aktet e procedimit penal

si:

- Vendim për rregjistrimin e procedimit pasuror nr.xxx datë xxxx.
- Shkresë nr.xxxx Prot datë xxxx mbi procedimin penal nr.xxxx të vitit xxxx ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx.
- Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr.xxx/xxxx para Gjykatës së Rrethit gjyqësor xxxx.
- Urdhër për rregjistrimin e veprës penale datë xxxx.
- Urdhër për rregjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale date xxxx.
- Vendim për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës datë xxxx.
- Vendim nr.xxx datë xxxx i Gjykatës së rrethit Gjyqësor xxxx.
- Shkresë nr.xxxx Prot datë xxxx drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- Shkresë nr.xxxx Prot datë xxxx drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxxx.
- Vendim për kqyrjen e dokumentave datë xxxx.
- Proces-verbal për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave datë xxxx.
- Kontratë shitje (pasuri e paluajtshme Truall + Objekt) , nr.xxx Rep, xxx Kol datë xxxx.
- Kontratë shitje (pasuri e paluajtshme Truall + Objekt), nr.xxx Rep, xxx Kol datë xxxx.
- Shkresë nr.xxxx Prot datë xxxx drejtuar Agjensisë së Legalizimeve, Urbanizimit, Integritit të Zonave të Ndërtimit Informale.Shkresa nr.xxxx Prot datë xxxx, xxxx datë xxxx drejtuar Drejtorise se Aluiznit xxxx.
- Shkresë nr.xxxx Prot datë xxxx drejtuar Prokurorisë s pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx (Bashkengjitur formularët nr.xxxx datë xxxx, nr.xxxx dhe xxxx Prot datë xxxx.

Në datë xxxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë paraqiti, para kësaj Gjykate, kërkesën me objekt sekuestrimin e e pasurisë së përshkruar më sipër, duke patur si bazë ligjore Ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në respektim të kërkesave të nenit 12 pika 1 të Ligjit në fjalë, brenda afatit ligjor pesëditor, të parashikuar në këtë dispozitë, mori në shqyrtim në seancë

gjqësore kërkesën e paraqitur.

Në kërkesë dhe në seancë gjyqësore prokurori i qëndroi pretendimeve në lidhje me dyshimet e ngritura për shtetasen O. H. (A.) duke pretenduar se ekzistonte rreziku i tjetërsimit i pronës objekt sekuestrimi.

Në funksion të provueshmërisë së pretendimeve dhe kërkesës në gjykim, prokurori paraqiti si provë aktet që kishin të bënin me regjistrimin e procedimit penal në

Gjykata në analizë të pretendimeve të prokurorit dhe provave të paraqitura prej tij, çmon se kërkesa është e drejtë, e bazuar ligj dhe prova dhe, si e tillë, duhet të pranohet për këto arsye:

I.Kërkesa u paraqit në zbatim të nenit 3 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të titulluar “Fusha e zbatimit”.

Në pikën 1 gërma “d” të Ligjit parashikohet zbatimi i tij për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicje, për kryerjen prej tyre të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ndërsa në pikën 2 gërma “a” të tij, zbatimi edhe mbi pasuritë e personave të afërm të subjektit të pikës 1.

U provua në gjykim se shtetasja O. H. (A.) është shtetase nën hetim për kryerje të veprës penale Fallsifikimit të dokumentave “ më shumë se njëherë “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, për të cilën është duke proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx dhe, për pasojë, ajo është subjekt i zbatimit të Ligjit, për shkak të dyshimeve dhe hetimeve që rëndojnë mbi të, duke ju nënshtruar pasuria e tij masave të parashikuara në të.

II. Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të Ligjit, gjykata çmon se për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasurinë është e domosdoshme ekzistenca njëkohësisht e dy kriterëve të përgjithshme që kanë të bëjnë me: **1.** Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. të bazuar në indicje. që tregojnë se personat mund të jenë të përfshirë në veprimtari kriminale. **2.** Zotërimin e pasurive dhe të ardhurave që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, si dhe ekzistenca e të paktën njërit prej kriterëve të veçanta, të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

Për sa më sipër, u arsyetua se mbi shtetasen O. H. (A.) rëndon dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicje, për përfshirje të tij në veprimtarinë kriminale të pastrimit të parave, që është një prej veprave penale që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit.

Ekziston rreziku real për tjetërsimin e pronës objekt sekuestrimi. Në kushtet e qënies së shtetasen O. H. (A.) , si subjekt i procedimit pasuror dhe marrjes, dijeni për masat e sekuestros, vendosur mbi pasurinë e disponuar prej tij, ekziston rreziku që ky shtetas të bëjë të gjitha përpjekjet për të tjetërsuar pasurinë, me qëllim shmangien nga një konfiskim i mundshëm (kriteri i veçantë i parashikuar në gërmën

“a” të pikës 1 të nenit 11).

Në bazë të pikës 2 të nenit 14 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi gjykata vlerësoi praninë e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për vendosjen e masës së sekuestros, çmon se ekziston detyrimi që të njoftojë zotëruesit e pasurive të sekuestruara, për vendimin e marrë prej saj. Në zbatim të kësaj dispozite, për realizimin e njoftimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile. Duke qënë se gjykata e gjeti kërkesën e paraqitur të drejtë dhe ligjore, vendimi i saj duhet t’i njoftohet shtetases nën hetim O. H. (A.).

Në bazë të pikës 3 të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15 të Ligjit në fjalë, kompetente për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të pasurive janë përmbaruesit gjyqësorë dhe, për administrimin e tyre administratorët e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Në këto kushte, është detyrim ligjor për gjykatën që në vendimin e saj të urdhërojë zyrën e përmbarimit, në juridiksionin e të cilës ndodhet pasuria e luajtshme (neni 516 i Kodit të Procedurës Civile) dhe, një administrator të agjensisë, të cilët do të koordinojnë punën për zbatimin e vendimit të sekuestros.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d”, nenit 5 pika 3, nenit 7 pika 1 dhe 2, nenit 11 pika 1 gërma “a”, nenit 12 pika 1 dhe 2, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës, vendosjen e masës së sekuestros mbi :
- Pasurinë me nr. xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, vol xxx ndodhur në lagjen “xxxx”, xxxx, me sipërfaqe xxxx m².
- Për ekzekutimin e vendimit të sekuestros ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxxx dhe, për administrimin e pasurive të sekuestruara, administratori E. B., në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.
- Urdhërohet K/Sekretaria, pranë kësaj Gjykate, t’i njoftojë shtetases nën hetim O. H.(A.), vendimin e sekuestrimit.
- Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit të veçantë, brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall sot në Tiranë, në datë 11.12.2015 ora 10.30.

SEKRETARE

Evloinda ADILI

GJYQTAR

Sandër SIMONI

